



ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
DRAFT PLANI I PUNËS I KOMITETIT PËR ÇËSHTJE GJINORE DHE PAKICA
PERIUDHA JANAR – DHJETOR 2013

Hyrje

Misioni i Odës së Avokatëve të Kosovës është, ta fuqizojë sundimin e ligjit në Kosovë duke siguruar praktikat më të mira dhe standardet më të larta të ushtrimit të ligjit, duke kontribuar dhe mbrojtur kështu sistemin gjyqësor të pavarur dhe të paanshëm, dhe duke promovuar kuptimin e publikut mbi ligjin dhe sistemin gjyqësor.

Në kuadër të OAK, misioni i Komitetit për çështje gjinore dhe pakica është të promovojë dhe lehtësojë anëtarësimin në OAK të avokateve femra dhe nga radhët e pakicave (vazhdon)

Komisioni për çështje gjinore dhe pakica siguron shërbime për anëtarësinë nëpërmjet dy komponentëve: (1) Komponenta e çështjeve gjinore; (2) Komponenta e çështjeve të pakicave

KOMPONENTA 1: ÇËSHTJET GJINORE

Komiteti për çështje gjinore dhe pakica do të bashkëpunojë me Universitetin e Prishtinës – Fakultetin Juridik (mund të parashihen edhe Universitetet private), Programin për Juristët në Kosovë të NCSC/USAID, dhe me partnerë të tjerë në arritjen e objektivit kryesor të Komitetit i cili është rritja e numrit të pjesëtareve femra në OAK.

Në veçanti gjatë kësaj periudhe Komiteti do të organizojë këto aktivitete:

- Lobimin me studentet femra të Universitetit të Prishtinës.
- Publikimi i konkursit për Ese.

Nxitja e femrave per hapjen e zyreve të avokatisë				+	+	+						
Vizita e femrave te dhunuara ku ato jane te strehuara						+				+	+	
Vizita e femrave neper burgje						+					+	+
Takimi me avokateve me gjyqetaret dhe prokuroret											+	
Kampanja përmes pamfletave dhe emisioneve televizive për vetëdisimin e femrave për të drejtën në trashëgimi									+			
Antarësimi i Komitetit në Degët Regjionale të Komuniteteve					+	+					+	+
Realizimi i takimit me femrat avokate te vendeve fqinjë										+		
Realizimi i dokumentarit “Femrat ne Drejtësi”											+	

KOMPONENTA 2: ÇËSHTJET E PAKICAVE

Komiteti për çështje gjinore dhe pakica do të bashkëpunojë me Programin për Juristët në Kosovë të NCSC/USAID, Këshillat Komunale për pakica dhe me partnerë të tjerë në arritjen e objektivit kryesor të Komitetit i cili është rritja e numrit të pjesëtareve nga radhët e pakicave në OAK.

Në veçanti gjatë kësaj periudhe Komiteti do të organizojë këto aktivitete:

- Vizita juristeve të komuniteteve në regjione të ndryshme të Kosovës, më qëllim që këto juriste të inkurajohen të inkuadrohen në profesionet ligjore.
- Lehtësime për anëtarësim anëtarëve të komuniteteve, p.sh pagesa e anëtarësisë më këste.
- Organizimi i 3 seminareve me komunitete në komunat ku ata janë të koncentruar
- Organizimi i 1 vizite jashtë Kosovës në shtetet ku është regulluar çështja e komuniteteve
- Organizimi i 1 seminari jashtë Kosovës
- Të organizohet një seminar jashtë Kosovës më pjesëtare të komitetit pakice, dhe anëtarët e Komitetit.
- Ndryshimi i procedurës së regjistrimit të pjesëtareve nga komuniteti.
- Sigurimi i një burse me NSCS për praktikant të komuniteteve.

Përgjegjës për zhvillimin e këtyre aktiviteteve do të jenë: Shpresa Rama (Kryesuese e Komitetit)

dhe anëtarët (të përcaktohen)

Rezultatet	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Kor	Gus	Sht	Tet	Nen	Dhj
Takimet me juristet nga komunitetet në regjione					+	+						
Kërkesa Bordit Ekzekutiv për pagesë me këste	+											
Planifikimi i vizitës dhe identifikimi i pjesëmarrësve për takimin me femrat avokate të shteteve fqinje									+			
Realizimi i vizitës në vendin ku është rregulluar çështja e komuniteteve										+		
Takimi me komitetin për praktikantë dhe NCSC rreth praktikantëve nga komunitetet pakicë	+	+	+									
Organizimi i 3 seminareve me komunitetet brenda Kosovës						+			+	+		

INDIKATORËT E PERFORMANSËS

Indikatorët do të shërbejnë për matjen e aktiviteteve të programit si ato ndërlidhen me rezultatet

dhe qëllimet e Planit të Punës. Të detajuara, indikatorët për komponentët dhe aktivitetet e

përcaktuara më lartë janë si në vijim:

KOMPONENTA 1:

Rezultatet	Indikatorët
Takimet me studentet e nivelit bachelor dhe master të Fakultetit Juridik të UP (ose/dhe Universiteteve private)	Takimet e realizuara me x studente të Fakultetit Juridik në periudhën Shtator – Dhjetor
Programi i mentorimit i hartuar	Programi i hartuar dhe i paraqitur për diskutim në Komitet dhe Bord Zgjedhja e x studenteve dhe x avokateve femra për mentorim
Iniciativa për programin e këshillimit të hartuar	Programi i hartuar dhe i paraqitur për diskutim në Komitet dhe Bord
Iniciativa për programin e këshillimit të implementuar	2 sesione të këshillimit të mbajtura

KOMPONENTA 2:

Rezultatet	Indikatorët
Takimet me juriste nga komunitetet në regjione	Takimet e realizuara me x juriste në regjione
Kërkesa Bordit Ekzekutiv për pagesë me këste	Kërkesa e parashtruar – vendimi i Bordit
Kërkesa Bordit/donatorëve për përkthim të revistës Avokati Kosovar në gjuhën serbe	Kërkesa e parashtruar – vendimi mbi aprovim
Planifikimi i vizitës dhe identifikimi i pjesëmarrësve	2 takime të mbajtura për planifikim dhe identifikim
Realizimi i vizitës	Vizita e realizuar
Kërkesë Bordit ekzekutiv për ndryshim të procedurës	Kërkesa e parashtruar – vendimi i Bordit
Takimi me komitetin për praktikantë dhe NCSC rreth praktikantëve nga komunitetet pakicë	2 takime të realizuara